



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË KAVAJË
KRYESIA

VENDIM

Nr. 3 datë 21/03/2025

“Për organizimin dhe njoftimin e rendit të ditës për mbledhjen eradhës të Këshillit Bashkiak Kavajë
Për 26 Mars 2025”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 93, datë 21.08.2020, neni 56, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 21/03/2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 26/03/2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit
(Ahmet Hoxhali)

2 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit
(Bruna Teliti)

3 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit
(_____)

4 - Anëtari i Kryesisë së Këshillit
(_____)

Kryetari i Këshillit Bashkiak
RUDIN HYLVIU

